

**TABELA E PËRPUTHSHMËRISË**

<b>Vendimi nr. 243/2012/be i Parlamentit Evropian dhe Këshillit i datës 14 mars 2012, mbi krijimin e programit shumëvjeçar të Politikës së Spektrit Radio, CELEX nr. 32012D0243</b>		<b>Legjislacioni shqiptar i propozuar: Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dokumentit të politikave spektrale”</b> <b>Përafrim i plotë</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përpuths hmëria	Shënime
<b>Neni 1</b>	<p align="center"><b>Neni 1</b> <b>Objekti dhe fusha e zbatimit</b></p> <p>1. Ky vendim miraton një program shumëvjeçar në lidhje me politikën spektrale për një planifikim strategjik dhe harmonizim të përdorimit të spektrit radio, për të garantuar një funksionim të tregut të brendshëm në sektorët e politikës së BE-së që kanë lidhje me përdorimin e spektrit radio, të tilla si politikat në fushën e komunikimeve elektronike, kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe hapësinor, transportit, energjisë dhe transmetimeve audiovizive.</p> <p>2. Ky Vendim nuk ka lidhje me disponibilitetin e nevojshëm të spektrit radio për fusha të tjera të politikës së BE-së, të tilla si mbrojtja civile dhe ndihma e shpejtë</p>		Neni 1 Objekti dhe qëllimi	<p align="center"><b>Neni 1</b> <b>Objekti dhe qëllimi</b></p> <p>Ky dokument miraton programin shumëvjeçar të politikës spektrale dhe ka për qëllim realizimin e planifikimit strategjik dhe harmonizimin e përdorimit të spektrit të frekuencave, për të garantuar një përdorim efikas të spektrit të frekuencave në përputhje me politikat e BE-së për përdorimin e spektrit të frekuencave, në fushën e komunikimeve elektronike, kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe hapësinor, transportit, energjisë dhe transmetimeve audiovizive.</p> <p align="center"><b>Neni 2</b> <b>Fusha e zbatimit</b></p> <p>1. Përcaktimet e këtij dokumenti zbatohen për spektrin e frekuencave për përdorim civil në fushën e komunikimeve</p>	I Plotë	

	<p>në rast katastrofash, si dhe politika e sigurisë dhe mbrojtjes së përbashkët.</p> <p>3. Ky Vendim nuk ndikon në ligjet në fuqi të BE-së, në veçanti Direktivat 1995/5/KE, 2002/20/KE dhe 2002/21/KE dhe nuk çënon nenin 6 të këtij Vendimi, Vendimin nr. 676/2002/KE si dhe masat e marra në nivel kombëtar, në përputhje me legjislacionin e BE-së.</p> <p>4. Ky Vendim nuk ndikon në masat e marra në nivel kombëtar, në përputhje me ligjet e BE-së, që ndjekin objektiva të interesit të përgjithshëm, në veçanti atë që kanë lidhje me rregullimin e përmbajtjes dhe me politikën e transmetimeve audiovizive.</p> <p>5. Ky Vendim nuk ndikon në të drejtën e Vendeve Anëtare për ta organizuar dhe përdorur spektrin e tyre radio për qëllime të rendit publik, sigurisë dhe mbrojtjes publike. Në rastin kur ky Vendim ose masat e marra në zbatim të tij për brezat e frekuencave të specifikuar në nenin 6 kanë të bëjnë me spektrin radio të përdorur nga një Vend Anëtar eskuzivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë për qëllime të sigurisë publike ose mbrojtje, Vendi Anëtar mund të vazhdojë, në masën e nevojshme, ta përdorë këtë brez frekuencash për qëllime të sigurisë publike dhe mbrojtjes, deri kur sistemet ekzistuese në këtë brez, në datën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi ose të një mase të marrë në zbatim të tij, respektivisht, nuk janë shfuqizuar gradualisht. Ky Vend Anëtar njofton Komisionin për vendimin e</p>		<p>Neni 2 Fusha e zbatimit</p>	<p>elektronike, kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe hapësinor, transportit, energjisë dhe transmetimeve audiovizive.</p> <p>2. Ky dokument nuk ndikon në disponueshmërinë e spektrit të frekuencave të nevojshëm për fushën e mbrojtjes civile, ndihmës së shpejtë në rast katastrofash, si dhe në politikat e sigurisë dhe mbrojtjes.</p> <p>3. Ky dokument nuk ndikon në rregullimet në fuqi lidhur me kërkesat teknike për pajisjet radio të komunikimeve dhe përcaktimet në ligjin për komunikimet elektronike në lidhje me administrimin e spektrit të frekuencave.</p> <p>4. Ky dokument nuk ndikon në rregullimet që ndjekin objektiva të interesit të përgjithshëm, në veçanti ato që kanë lidhje me rregullimin e përmbajtjes në transmetimet audiovizive.</p> <p>5. Ky dokument nuk ndikon në të drejtën për ta organizuar dhe përdorur spektrin radio për qëllime të rendit publik, sigurisë dhe mbrojtjes publike sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.</p>		
--	---	--	------------------------------------	--	--	--

	tij.				
Neni 2 Parime të përgjithshme rregullatore	<p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b> <b>Parime të përgjithshme rregullatore</b></p> <p>1. Vendet Anëtare bashkëpunojnë ndërmjet tyre si dhe me Komisionin në mënyrë transparente, për të garantuar aplikimin koherent në të gjithë BE-në të parimeve të përgjithshme rregullatore, si mëposhtë:</p> <p>a) Zbatimin e një sistemi autorizimi sa më të përshtatshëm dhe të thjeshtuar, në mënyrë që të fuqizojë maksimalisht fleksibilitetin dhe efikasitetin në përdorimin e spektrit radio. Ky sistem autorizimesh bazohet në kritere objektive, transparente, jo diskriminuese dhe proporcionale;</p> <p>b) Favorizim të zhvillimit të tregut të brendshëm duke promovuar shfaqjen e shërbimeve të ardhshme digjitale në nivel të BE-së dhe duke nxitur një konkurrencë efektive;</p> <p>c) Promovim të konkurrencës dhe inovacionit, duke mbajtur parasysh nevojën për të shmangur interferenca të dëmshme dhe nevojën për të siguruar cilësinë teknike të shërbimit, në mënyrë që të lehtësohet vënia në dispozicion e shërbimeve broadband dhe t'i përgjigjet në mënyrë efektive rritjes së trafikut të të dhënave me wireless;</p> <p>d) Përcaktimin e kushteve teknike për përdorimin e spektrit radio, duke marrë parasysh plotësisht ligjin përkatës të BE-së, edhe në lidhje me kufizimin e</p>	Neni 4 Parime të përgjithshme rregullatore	<p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Parime të përgjithshme rregullatore</b></p> <p>1. Përdorimi i spektrit të frekuencave, në fushën e komunikimeve elektronike, kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe hapësinor, transportit, energjisë dhe transmetimeve audiovizive duhet të bazohet në zbatimin e një sistemi autorizimi apo licensimi sa më të përshtatshëm dhe të thjeshtuar, në mënyrë që të garantohet maksimalisht fleksibiliteti dhe efikasiteti në përdorimin e spektrit të frekuencave në këto fusha.</p> <p>2. Sistemi i autorizimeve ose licensimeve për përdorimin e spektrit të frekuencave bazohet në kritere objektive, transparente, jo diskriminuese dhe proporcionale.</p> <p>3. Përdorimi i spektrit të frekuencave, duhet të mbështesë:</p> <p>a) zhvillimin e tregut të brendshëm duke promovuar prezantimin e shërbimeve të ardhshme digjitale në nivel kombëtar dhe të nxisë konkurrencën efektive;</p> <p>b) promovimin e konkurrencës dhe inovacionit, duke siguruar shmangien e interferencave të dëmshme dhe garantuar cilësinë teknike të shërbimit, në mënyrë që të lehtësohet vënia në dispozicion e shërbimeve broadband duke iu përgjigjur në mënyrë efektive rritjes së</p>	I Plotë	

	<p>eksponimit të popullsisë ndaj fushave elektromagnetike;</p> <p>e) Promovimin, ku është e mundur, të principeve të neutralitetit teknologjik dhe të shërbimeve në të drejtat e përdorimit të spektrit radio.</p> <p>2. Për komunikimet elektronike, përveç parimeve të përgjithshme rregullatore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, do të zbatohen parimet specifike në vijim, në përputhje me nenet 8a, 9, 9a dhe 9b të Direktivës 2002/21/KE dhe me Vendimin nr. 676/2002/KE:</p> <p>a) Aplikimi i parimeve të neutralitetit teknologjik dhe të shërbimeve në të drejtat e përdorimit të spektrit radio për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, dhe transferimin dhe dhënien me qera të të drejtave individuale për përdorimin e radiofrekuencave;</p> <p>b) Promovimi i harmonizimit të përdorimit të radiofrekuencave në të gjithë BE-në, në përputhje me nevojën për të siguruar një përdorim efektiv dhe efikas;</p> <p>c) Favorizimi i rritjes së trafikut të të dhënave me wireless dhe të shërbimeve broadband, duke nxitur në veçanti fleksibilitetin, dhe promovimi i inovacionit, duke marrë parasysh nevojën për të shmangur interferencat e dëmshme dhe për të siguruar cilësinë teknike të shërbimit.</p>			<p>trafikut të të dhënave në rrjetet pa tel (radio);</p> <p>c) përcaktimin e kushteve teknike për përdorimin e spektrit të frekuencave, duke marrë parasysh plotësisht legjislacionin përkatës në lidhje me kufizimin e ekspozimit të popullsisë ndaj fushave elektromagnetike, brenda normave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave;</p> <p>d) promovimin, kur është e mundur, të parimit të neutralitetit teknologjik dhe të shërbimeve në të drejtat e përdorimit të spektrit të frekuencave.</p> <p>4. Për komunikimet elektronike, përveç parimeve të përgjithshme rregullatore të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, zbatohen parimet specifike në përputhje me ligjin për komunikimet elektronike si:</p> <p>a) aplikimi i parimit të neutralitetit teknologjik dhe të shërbimeve në të drejtat e përdorimit të frekuencave për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, për transferimin apo dhënien me qera të të drejtave individuale për përdorimin e frekuencave;</p> <p>b) promovimi i harmonizimit të përdorimit të frekuencave në të gjithë vendin, në përputhje me nevojën për të siguruar një përdorim efektiv dhe efikas;</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>c) mbështetja e rritjes së trafikut të të dhënave dhe të shërbimeve broadband, duke nxitur në veçanti fleksibilitetin, dhe promovimin e inovacionit, si duke marrë parasysh nevojën për të shmangur interferencat e dëmshme dhe për të siguruar cilësinë teknike të shërbimit.</p> <p>5. Autoritetet e administrimit të spektrit të frekuencave bashkëpunojnë ndërmjet tyre si dhe kur është e nevojshme me ministrin për të garantuar zbatimin koherent e në mënyrë transparente, të gjitha parimeve të përgjithshme rregullatore si më sipër.</p>		
Neni 3 Objektivat strategjikë	<p><b>Neni 3</b> <b>Objektivat strategjikë</b> Për të përqëndruar prioritetet e këtij Vendimi, Vendet Anëtare dhe Komisioni bashkëpunojnë për të mbështetur dhe arritur objektivat e mëposhtëm strategjikë:</p> <p>a) Nxitje të administrimit dhe përdorimit eficient të spektrit radio, për të përmbushur më mirë kërkesën në rritje për përdorimin e frekuencave, nën dritën e vlerës së rëndësishme sociale, kulturore dhe ekonomike të spektrit të radios;</p> <p>b) Të caktohet një spektër radio i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për të përmbushur objektivat strategjikë të BE-së, që i përgjigjet sa më mirë kërkesës për trafik të dhënash me wireless, duke mundësuar në këtë mënyrë zhvillimin e shërbimeve tregtare dhe publike, dhe duke marrë parasysh objektiva të rëndësishëm</p>		Neni 5 Objektivat strategjikë	<p><b>Neni 5</b> <b>Objektivat strategjikë</b> Objektivat strategjikë për politikën e spektrit të frekuencave synojnë:</p> <p>a) Nxitjen e administrimit dhe përdorimit eficient të spektrit radio, për të përmbushur më mirë kërkesën në rritje për përdorim të frekuencave, me vlerë të rëndësishme sociale, kulturore dhe ekonomike.</p> <p>b) Caktimin e një sasive të mjaftueshme dhe të përshtatshme të spektrit për të përmbushur objektivat strategjikë të agjendës digjitale, që i përgjigjet sa më mirë kërkesës për trafik të dhënash mbi rrjetet radio (pa tel), duke mundësuar në këtë mënyrë zhvillimin e shërbimeve të biznesit dhe atyre publike, dhe duke marrë</p>	I plote	

	<p>të interesit të përgjithshëm, të tillë si diversiteti kulturor dhe pluralizmi i medias; për këtë qëllim, duhet bërë çdo përpjekje për të identifikuar, bazuar në inventarin e spektrit radio të cituar në nenin 9, të paktën 1200MHz spektër radio në dispozicion brenda vitit 2015. Kjo vlerë përfshin spektrin radio aktualisht në përdorim;</p> <p>c) Tejkalim i hendekut digjital dhe kontribut në objektivat e Agjendës Digjitale Evropiane, duke favorizuar aksesin në broadband me një shpejtësi të paktën 30 Mbps për të gjithë shtetasit e BE-së brenda vitit 2020 dhe duke mundësuar në këtë mënyrë që BE të shfrytëzojë në mënyrë maksimale kapacitetin dhe shpejtësinë e shërbimeve broadband;</p> <p>d) Të lejojë që BE-ja të marrë një rol drejtues në sektorin e shërbimeve broadband për komunikimet elektronike wireless, duke vënë në dispozicion spektër radio të mjaftueshëm në breza eficientë në planin e kostove, me qëllim që këto shërbime të jenë gjërësisht të disponueshme;</p> <p>e) Garantim i mundësive për sektorin e tregtisë dhe atë publik, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të broadband-it mobile;</p> <p>f) Promovim i inovacionit dhe i investimeve, duke përforcuar fleksibilitetin në përdorimin e spektrit radio, nëpërmjet aplikimit koherent në të gjithë BE-në të parimeve të neutralitetit</p>			<p>parasysh njëkohësisht objektivat e rëndësishëm të interesit të përgjithshëm, të tilla si garantimi i diversitetit kulturor dhe pluralizmit të medias.</p> <p>c) Kapërcimin e hendekut digjital në mbulimin me shërbime të zonave rurale dhe të largëta si dhe arritjen e objektiveve të Planit Kombëtar për zhvillimin e infrastrukturës digjitale broadband, dhe Agjendës Digjitale, duke mbështetur aksesin në broadband me një shpejtësi të lartë dhe shumë të lartë për të gjithë vendin e duke mundësuar në këtë mënyrë shfrytëzimin në mënyrë maksimale të kapacitetit dhe shpejtësisë së shërbimeve broadband.</p> <p>d) Të mundësojnë zhvillimin e shërbimeve broadband për komunikimet elektronike në rrjetet pa tel, duke vënë në dispozicion spektër radio të mjaftueshëm në breza eficientë në lidhje me kostot, me qëllim që këto shërbime të jenë gjërësisht të disponueshme për publikun.</p> <p>e) Garantimin e mundësive për sektorin privat dhe atë publik, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të broadband-it të lëvizshëm.</p> <p>f) Promovimin e inovacionit dhe të investimeve, duke përforcuar fleksibilitetin në përdorimin e spektrit radio, nëpërmjet aplikimit të parimeve të neutralitetit teknologjik midis zgjidhjeve teknologjike që mund të zbatohen dhe nëpërmjet një parashikimi të përshtatshëm</p>		
--	--	--	--	--	--	--

	<p>teknologjik dhe të shëbimeve midis zgjidhjeve teknologjike që mund të zbatohen dhe nëpërmjet një parashikimi të përshtatshëm rregullator, siç është parashikuar, ndër të tjera, në kuadrin rregullator për komunikimet elektronike, nëpërmjet hapjes së spektrit radio të harmonizuar për teknologjitë e reja të avancuara, si dhe mundësisë së shkëmbimit të të drejtave të përdorimit të spektrit radio, duke krijuar në këtë mënyrë mundësi për zhvillimin e shërbimeve të ardhshme digjitale në nivel BE-je;</p> <p>g) Lehtësimin e aksesit në spektrin radio duke shfrytëzuar përfitimet e autorizimeve të përgjithshme për komunikimet elektronike, në përputhje me nenin 5 të Direktivës 2002/20/KE;</p> <p>h) Nxitje të përdorimit të përbashkët të infrastrukturave pasive, në rastet kur ky përdorim është i proporcionuar dhe jo diskriminues, siç parashikohet në nenin 12 të Direktivës 2002/21/KE;</p> <p>i) Mbajtje dhe zhvillim i konkurrencës efektive, në veçanti në shërbimet e komunikimeve elektronike, duke shmangur, nëpërmjet masave ex ante ose korrigjimeve ex post, akumulimin e tepërt të të drejtave të përdorimit të radiofrekuencave nga kompani të caktuara, gjë që do të rezultonte në një shtrembërim të konsiderueshëm të konkurrencës;</p>			<p>rregullator, bazuar midis të tjerash në ligjin për komunikimet elektronike, dhe nëpërmjet lirit të spektrit radio në harmoni me zhvillimet në BE për teknologjitë e reja të avancuara, si dhe përmes mundësisë së transferimit/tregtimit të të drejtave të përdorimit të spektrit radio, duke krijuar në këtë mënyrë mundësi për zhvillimin e shërbimeve të ardhshme digjitale.</p> <p>g) Lehtësimin e aksesit në spektrin radio duke shfrytëzuar përfitimet e autorizimeve të përgjithshme për komunikimet elektronike, në përputhje me ligjin për komunikimet elektronike dhe sipas praktikave të BE-së.</p> <p>h) Nxitjen e përdorimit të përbashkët të infrastrukturave pasive, në rastet kur ky përdorim është proporcional dhe jo diskriminues.</p> <p>i) Sigurimin dhe zhvillimin e konkurrencës efektive, në veçanti për shërbimet e komunikimeve elektronike, duke shmangur, nëpërmjet masave ex-ante ose të korrigjimeve ex-post, akumulimin e tepërt të të drejtave të përdorimit të frekuencave nga kompani të caktuara, gjë që do të rezultonte në një shtrembërim të konsiderueshëm të konkurrencës.</p> <p>j) Reduktim të fragmentizimit dhe shfrytëzim të plotë të potencialit të tregut të brendshëm me qëllim favorizimin e rritjes ekonomike dhe të ekonomive të shkallës, duke përmirësuar, kur është e përshtatshme,</p>		
--	---	--	--	--	--	--

	<p>j) Reduktim i fragmentizimit dhe shfrytëzim i plotë i potencialit të tregut të brendshëm me qëllim favorizimin e rritjes ekonomike dhe të ekonomive shkallë në nivel të BE-së, duke përmirësuar, ku është e përshtatshme, koordinimin dhe harmozimin e kushteve teknike për përdorimin dhe disponibilitetin e spektrit radio;</p> <p>k) Shmangie të interferencave të dëmshme ose të shqetësimeve që vijnë si rezultati i pajisjeve të tjera radio dhe jo, ndër të tjera duke lehtësuar zhvillimin e standardeve që kontribuojnë në përdorimin efikas të spektrit radio dhe rritjen e imunitetit të marrësve ndaj interferencave, duke marrë parasysh në veçanti ndikimin akumulativ të vëllimit dhe dendësisë në rritje të pajisjeve dhe aplikacioneve radio;</p> <p>l) Promovim i aksesit të produkteve të reja dhe të teknologjive të reja të konsumit, në mënyrë që konsumatorët të mbështesin kalimin në teknologjinë digjitale dhe sigurimin e përdorimit efikas të dividentit digjital;</p> <p>m) Reduktim i karbonit të emetuar në BE duke përforcuar efikasitetin teknike dhe energjitike të rrjeteve të komunikimit dhe të pajisjeve wireless.</p>			<p>koordinimin dhe harmonizimin e kushteve teknike për përdorimin dhe disponibilitetin e spektrit radio.</p> <p>k) Shmangien e interferencave të dëmshme ose të shqetësimeve që vijnë si rezultati i pajisjeve të tjera radio, duke lehtësuar ndër të tjera zhvillimin e standardeve që kontribuojnë në përdorimin efikas të spektrit radio dhe rritjen e imunitetit të marrësve ndaj interferencave, duke marrë parasysh në veçanti ndikimin akumulativ të vëllimit dhe dendësisë në rritje të pajisjeve dhe aplikacioneve radio.</p> <p>l) Promovimin e aksesit në produktet e reja dhe të teknologjive të reja, në mënyrë që konsumatorët të mbështesin kalimin në teknologjinë digjitale dhe sigurimin e përdorimit efikas të dividentit digjital.</p> <p>m) Reduktim të sasisë së karbonit të emetuar nga përdorimi i pajisjeve radio duke përforcuar efikasitetin teknike dhe energjitike të rrjeteve të komunikimit dhe të pajisjeve radio.</p>		
<p>Neni 4 Përmirësim i efikasitetit dhe fleksibilitetit</p>	<p><b>Neni 4</b> <b>Përmirësim i efikasitetit dhe fleksibilitetit</b> 1. Vendet Anëtare, në bashkëpunim me Komisionin, favorizojnë, kur është e</p>		<p>Neni 6 Përmirësim i i</p>	<p><b>Neni 6</b> <b>Përmirësimi i efikasitetit dhe fleksibilitetit</b> 1. Në administrimin e spektrit të</p>	<p>I plote</p>	



	<p>përshtatshme, përdorimin kolektiv dhe të përbashkët të spektrit radio. Vendet Anëtare, gjithashtu, favorizojnë zhvillimin e teknologjive ekzistuese dhe të reja, për shembull, në fushën e radio njohjes, përfshirë ato që përdorin “hapësirat e bardha”.</p> <p>2. Vendet Anëtare dhe Komisioni bashkëpunojnë për të përmirësuar fleksibilitetin në përdorimin e spektrit radio, për të promovuar inovacionin dhe investimet, nëpërmjet mundësisë së përdorimit të teknologjive të reja dhe nëpërmjet transferimit ose dhënies me qera të të drejtave të përdorimit të spektrit radio.</p> <p>3. Vendet Anëtare dhe Komisioni bashkëpunojnë për të nxitur zhvillimin dhe harmonizimin e standardeve për pajisjet radios dhe fundore të telekomunikacionit, si dhe të çdo rrjeti dhe pajisje elektrike dhe elektronike të bazuar në mandatet e standartizimit të lëshuara nga Komisioni për organet përkatëse të standardizimit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet standardeve për pajisjet për personat me aftësi të kufizuara.</p> <p>4. Vendet Anëtare mbështesin Kërkimin dhe Zhvillimin në fushën e teknologjive të reja, si teknologjitë njohëse dhe bazat e të dhënave të gjeolokalizimit.</p> <p>5. Vendet Anëtare caktojnë, sipas rastit, kritere dhe procedura përzgjedhjeje për dhënien e së drejtës së përdorimit të spektrit radio, të cilat promovojnë konkurrencën,</p>		<p>efiçences dhe fleksibilitet it</p>	<p>frekuencave, kur është e përshtatshme, do nxitet përdorimi i përbashkët i spektrit të frekuencave për të mbështetur zhvillimin e teknologjive ekzistuese dhe të reja, si teknologjitë e njohjes (cognitive technologies), përfshirë ato që përdorin “hapësirat e bardha”.</p> <p>2. Autoritetet përgjegjëse për administrimin e spektrit bashkëpunojnë për të përmirësuar fleksibilitetin në përdorimin e spektrit radio, për të promovuar inovacionin dhe investimet, nëpërmjet mundësisë së përdorimit të teknologjive të reja dhe nëpërmjet transferimit ose dhënies me qera të të drejtave të përdorimit të spektrit radio.</p> <p>3. Autoritetet përgjegjëse për administrimin e spektrit dhe ministria bashkëpunojnë për të nxitur zhvillimin dhe harmonizimin e standardeve për pajisjet radios të komunikimit, si dhe të çdo rrjeti dhe pajisje elektrike dhe elektronike me organet përkatëse të standardizimit. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet standardeve për pajisjet për personat me aftësi të kufizuara me qëllim sigurimin e shërbimit universal.</p> <p>4. Në proceset e planifikimit dhe administrimit të spektrit do mbështeten veprimtaritë e kërkimit dhe zhvillimit në fushën e teknologjive të reja, si teknologjitë njohëse dhe bazat e të dhënave të vendodhjes gjeografike.</p> <p>5. Në administrimin e spektrit sipas rastit dhe specifikave të shërbimit caktohen, kritere dhe procedura përzgjedhjeje për dhënien e së drejtës së përdorimit të spektrit radio, të cilat promovojnë konkurrencën, investimet dhe përdorimin</p>		
--	--	--	---------------------------------------	--	--	--

	<p>investimet dhe përdorimin efektiv të spektrit radio si një të mirë publike, si dhe bashkëjetesën e shërbimeve dhe pajisjeve të reja dhe ekzistuese. Vendet Anëtare promovojnë përdorimin eficient të vazhdueshëm të spektrit radio për rrjetet, pajisjet dhe aplikacionet.</p> <p>6. Kur është e nevojshme, për sigurimin e përdorimit efektiv të të drejtave të përdorimit të spektrit radio dhe për të shmangur akumulimin e spektrit radio, Vendet Anëtare mund të marrin në konsideratë miratimin e masave të nevojshme, të tilla si sanksione financiare, aplikim i tarifave nxitëse ose tërheqje të të drejtave. Masa të tilla vendosen dhe zbatohen në mënyrë transparente, jo diskriminuese dhe proporcionale.</p> <p>7. Për shërbimet e komunikimeve elektronike, Vendet Anëtare miratojnë brenda datës 1 janar 2013 masa për alokimet dhe autorizimet të përshtatshme për zhvillimin e shërbimeve broadband, në përputhje me Direktivën 2002/20/KE, në mënyrë që të arrihet kapaciteti dhe shpejtësia maksimale e mundshme për broadband-in.</p> <p>8. Për të shmangur fragmentizimin e mundshëm të tregut të brendshëm, si rrjedhojë e kriterëve dhe kushteve të përzgjedhjes, të ndryshme, të aplikueshme për spektrin radio të harmonizuar, të caktuar për shërbime të komunikimeve elektronike dhe që mund të jenë objekt i shkëmbimeve</p>			<p>efektiv të spektrit radio si një e mirë publike, si dhe për bashkëjetesën e shërbimeve dhe pajisjeve të reja me ato ekzistuese, që promovojnë përdorimin eficient e të vazhdueshëm të spektrit radio për rrjetet, pajisjet dhe aplikacionet.</p> <p>6. Kur është e nevojshme, për sigurimin e përdorimit efektiv të spektrit radio dhe për të shmangur akumulimin e spektrit radio apo mospërdorimin e tij, autoritetet përgjegjëse për administrimin e spektrit mund të ndër marrin masat e nevojshme, të tilla si vendosjen e sanksioneve financiare, aplikimin e tarifave nxitëse ose heqje/revokimin e të drejtave. Masa të tilla do vendosen dhe zbatohen në mënyrë transparente, jo diskriminuese dhe proporcionale në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>7. Për shërbimet e komunikimeve elektronike, të merren masa për alokimet dhe autorizimet të përshtatshme për zhvillimin e shërbimeve broadband, në përputhje me ligjin për komunikimet elektronike, në mënyrë që të arrihet kapaciteti dhe shpejtësia maksimale e mundshme për broadband-in.</p> <p>8. Për të shmangur fragmentizimin e mundshëm në dhënien në përdorim të frekuencave, si rrjedhojë e kriterëve dhe kushteve të përzgjedhjes të ndryshme, të aplikueshme për spektrin radio, të caktuar për shërbime të komunikimeve elektronike, ministria në bashkëpunim me AKEP dhe AMA do të kryejnë një analizë të procedurave ekzistuese dhe iniciojnë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe/ose nënligjore për adoptimin e praktikave më të mira në lidhje me</p>		
--	--	--	--	--	--	--

	<p>në të gjithë Vendet Anëtare, sipas nenit 9c të Direktivës 2002/21/KE, Komisioni, në bashkëpunim me Vendet Anëtare dhe në përputhje me parimin e subsidiaritetit, lehtëson identifikimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në lidhje me kushtet dhe procedurat e autorizimit dhe nxit shkëmbimin e informacionit për këtë spektër me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë në të gjithë BE-në, në linjë me parimet e neutralitetit teknologjik dhe të shërbimeve.</p>			<p>kushtet dhe procedurat e autorizimit bazuar në praktikën e BE-së dhe Kodin e ri të Komunikimeve Elektronike (EECC) të miratuar me Direktivën 2018/1972/EU.</p> <p>9. Me qëllim arritjen e objektivave strategjike do të kryhet një analizë mbi sistemin aktual të pagesave për spektrin e frekuencave në veçanti për ato qëmbështeten në shërbimet satelitore broadband me qëllim që këta breza të jenë më të përdorshëm si dhe pagesat për autorizimet individuale për përdorim të frekuencave me kohëzgjatje të kufizuar, për qëllime kërkimore, testimi (provë/kërkim/matje) të teknologjive të reja në breza të ndryshëm të frekuencave apo për frekuencat që caktohen në rastet e katastrofave, fatkeqësive natyrore, emegjencave, luftës, etj.</p>		
Neni 5 Konkurrenca	<p>Neni 5 Konkurrenca</p> <p>1. Vendet Anëtare promovojnë konkurrencën efektive dhe shmangin shtrembërime të konkurrencës në tregun e brendshëm për shërbimet e komunikimeve elektronike në përputhje me Direktivat 2002/20/KE dhe 2002/21/KE.</p> <p>Gjithashtu, ata marrin parasysh aspekte të konkurrencës në momentin kur u japin të drejta për përdorimin e spektrit radio, përdoruesve të rrjeteve private të komunikimeve elektronike.</p> <p>2. Për qëllimet e paragrafit të parë të pikës 1 dhe pa çënuar zbatimin e rregullave të konkurrencës dhe masave të marra nga</p>		Neni 5 Konkurenc a	<p>Neni 7 Konkurrenca</p> <p>1. Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave duhet të promovojnë konkurrencën efektive dhe shmangin shtrembërime të konkurrencës në ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Në procesin e dhënies në përdorim të frekuencave administratorët e spektrit marrin parasysh aspekte të konkurrencës në momentin kur u japin të drejta për përdorimin e spektrit radio, përdoruesve të rrjeteve private të komunikimeve elektronike.</p> <p>2. Me qëllim garantimin e konkurrencës, pa çënuar zbatimin e rregullave të konkurrencës dhe masave të marra në zbatim të</p>	I plote	

	<p>Vendet Anëtare për arritjen e objektivave të interesit të përgjithshëm, në përputhje me nenin 9, pika 4, e Direktivës 2002/21/KE, Vendet Anëtare mund të aplikojnë, ndër të tjera, masat e mëposhtme:</p> <p>a) Kufizim të sasisë së spektrit radio për të cilin mund të lëshojnë të drejta përdorimi për një kompani ose caktim kushtesh për këto të drejta përdorimi, të tilla si sigurimin e aksesit me shumicë, roaming kombëtar ose rajonal, në secilin prej brezave ose në secilin prej grupeve të brezave me karakteristika të ngjashme, për shembull për brezat nën 1 GHz të caktuara për shërbime të komunikimeve elektronike. Këto kushte shtesë mund të vendosen vetëm nga autoritetet kombëtare kompetente;</p> <p>b) Rezervim, aty ku është e përshtatshme për shkak të situatës në tregun kombëtar, të një pjese të caktuar brezi ose të një grupi brezash frekuence për t'u caktuar operatorëve të rinj;</p> <p>c) Refuzim të dhënies të së drejtave të reja për përdorim të spektrit radio ose të autorizimeve të reja për përdorim të spektrit radio në secilin prej brezave, ose caktim të kushteve të veçanta për dhënien e të drejtave të reja për përdorimin e spektrit radio ose për autorizimin e përdorimit të ri të spektrit radio, për të shmangur shtrembërime të konkurrencës për shkak të caktimit, transferimit ose akumulimit të mundshëm të të drejtave të përdorimit;</p> <p>d) Ndalim ose vendosje kushtesh për</p>			<p>legjislacionit në fuqi për arritjen e objektivave të interesit të përgjithshëm, në dhënien në përdorim të frekuencave mund të aplikohen, ndër të tjera, masat e mëposhtme:</p> <p>a) Kufizim i sasisë së spektrit radio për të cilin mund të lëshojnë të drejta përdorimi për një kompani, ose përcaktim kushtesh për këto të drejta përdorimi, të tilla si sigurimin e aksesit me shumicë, sigurimin e roamingut kombëtar ose rajonal, në secilin prej brezave ose në secilin prej grupeve të brezave me karakteristika të ngjashme, si për shembull për brezat nën 1 GHz të caktuara për shërbime të komunikimeve elektronike.</p> <p>b) Aty ku është e përshtatshme për shkak të situatës në tregun kombëtar, rezervimin e një pjese të caktuar brezi ose të një grupi brezash frekuence për t'u caktuar operatorëve të rinj me qëllim nxitjen e konkurrencës.</p> <p>c) Refuzim të dhënies të së drejtave të reja për përdorim të spektrit radio, ose të autorizimeve të reja për përdorim të spektrit radio, ose caktim të kushteve të veçanta të mbulimit, shërbimit universal në dhënien e të drejtave të reja për përdorimin e spektrit radio ose për autorizimin e përdorimit të ri të spektrit radio, për të shmangur shtrembërime të konkurrencës për shkak të caktimit, transferimit ose akumulimit të mundshëm të të drejtave të përdorimit.</p> <p>d) Ndalim ose vendosje kushtesh për transferimin e të drejtave të përdorimit të spektrit radio, në rastin kur transferime të tilla mund të ndikojnë ndjeshëm në konkurrencë;</p> <p>e) Ndryshimin e të drejtave ekzistuese në përputhje me parashikimet ligjore, kur kjo është e nevojshme për të korrigjuar “ex post”</p>		
--	--	--	--	--	--	--

	<p>transferimin e të drejtave të përdorimit të spektrit radio, që nuk i nënshtrohen kontrollit kombëtar apo të BE-së, në rastin kur transferime të tilla mund të ndikojnë ndjeshëm në konkurrencë;</p> <p>e)Ndryshim i të drejtave ekzistuese në përputhje me Direktivën 2002/20/KE, kur kjo është e nevojshme për të korrigjuar ex post shtrembërime të konkurrencës që kanë ardhur si rrjedhojë e transferimeve ose akumulimeve të të drejtave të përdorimit të frekuencave radio.</p> <p>3. Kur Vendet Anëtare synojnë të marrin një nga masat e përmendura në pikën 2 të këtij neni, ato veprojnë në përputhje me procedurat për caktimin ose modifikimin e kushteve, të cilat kanë lidhje me të drejtat e përdorimit të spektrit radio të përcaktuara në Direktivën 2002/20/KE.</p> <p>4. Vendet Anëtare garantojnë që procedurat e autorizimit dhe përzgjedhjes për shërbimet e komunikimeve elektronike të promovojnë konkurrencën efektive në favor të qytetarëve, konsumatorëve dhe kompanive të BE-së.</p>			<p>shtrembërime të konkurrencës që kanë ardhur si rrjedhojë e transferimeve ose akumulimeve të të drejtave të përdorimit të frekuencave radio tek një kompani.</p> <p>3. Në rastin kur është e nevojshme të ndërmerren masat sipas pikës 2 të këtij neni, autoritetet e administrimit të spektrit veprojnë në përputhje me procedurat për caktimin ose modifikimin e kushteve, në lidhje me të drejtat e përdorimit të spektrit radio të përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p>4. Vendimet e marra për dhënien në përdorim të frekuencave duhet të garantojnë që procedurat e autorizimit dhe përzgjedhjes për shërbimet e komunikimeve elektronike promovojnë konkurrencën efektive në favor të qytetarëve, konsumatorëve dhe biznesit.</p>		
Neni 6 Nevojat e spektrit për komunikimet broadband wireless	<p><b>Neni 6</b> <b>Nevojat e spektrit për komunikimet broadband wireless</b></p> <p>1. Vendet Anëtare, në bashkëpunim me Komisionin, marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar vënien në dispozicion të spektrit radio të mjaftueshëm për të siguruar mbulimin</p>		Neni 8 Nevoja e spektrit për komunikim et broadband pa tel	<p><b>Neni 9</b> <b>Nevojat e spektrit për komunikimet broadband wireless</b></p> <p>1. Zhvillimet teknologjike, rritja e përdorimit të pajisjeve radio dhe rritja e shpejtë e trafikut të të dhënave me brez të gjerë, kanë bërë që zgjerimi i kapaciteteve të rrjeteve të komunikimit</p>	E pjesëshme	Pershtatur me situatën e vendit

	<p>dhe kapacitetet e nevojshme brenda BE-së, në mënyrë që BE-ja të ketë në dispozicion broadband-in me shpejtësinë më të lartë në botë, në mënyrë që aplikacionet wireless dhe roli udhëheqës evropian në shërbimet e reja të mund të kontribuojnë efektivisht në rritjen ekonomike dhe në realizimin e objektivit për një akses në broadband me shpejtësi prej 30 Mbps deri në 2020 për të gjithë qytetarët.</p> <p>2. Në mënyrë që të promovojë vënien në dispozicion më gjërësisht të shërbimeve broadband, në përfitim të qytetarëve dhe të konsumatorëve të BE-së, Vendet Anëtare vënë në dispozicion brezat e përcaktuara nga Vendimet 2008/411/KE (3,4-3,8 GHz), 2008/477/KE (2,5-2,69 GHz) dhe 2009/766/KE (900-1800 MHz) sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këto vendime. Në varësi të kërkesës së tregut, Vendet Anëtare përmbushin procesin e autorizimeve brenda datës 31 dhjetor 2012, pa cënuar disponibilitetin e shërbimeve ekzistuese dhe me kushte që i lejojnë konsumatorët të kenë akses të thjeshtuar në shërbimet broadband wireless.</p>			<p>elektronik pa tel (broadband wireless), është bërë një domosdoshmëri.</p> <p>2. Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të spektrit të frekuencave për këto zhvillime është me rëndësi për përmbushjen e kërkesës në rritje për trafikun e të dhënave me brez të gjerë dhe nxitjen e zhvillimit të shërbimeve inovative të komunikimit digjital ku po mbështeten gjithnjë e më shumë zhvillimet e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.</p> <p>3. Bazuar në keto zhvillime teknologjike organizmat ndërkombëtare ITU, CEPT, kanë kaluar përdorimin e brezit 700 MHz në Rajonin 1, ku bën pjesë dhe Shqipëria, për shërbime të rrjeteve të lëvizshme LTE.</p> <p>4. Bashkimi Europian me vendimin nr. 2017/899/EU, ka përcaktuar si datë për lirim të këtij brezi 30 qershorin 2020 duke lënë si afat maksimal 30.6.2022, për rastet e justifikuara kryesisht të lidhura me nevojën e koordinimit ndërkufitar.</p> <p>5. Plani Kombëtar i Frekuencave miratuar me VKM nr. 277, datë 29.3.2017, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave" ka parashikuar tek shënimet që brezi i 700 MHz (DD2), është identifikuar për shërbime të lëvizshme me brez të gjerë në të ardhmen.</p> <p>6. Brezi i frekuencave 700 MHz, ose i njohur si Digital Dividend 2 (DD2) është</p>		
--	---	--	--	---	--	--

	<p>3. Vendet Anëtare do të inkurajojnë përditësimin e vazhdueshëm, nga ana e ofruesve të komunikimeve elektronike, të rrjeteve të tyre me teknologjinë më të fundit dhe më efikase, në mënyrë që të krijojnë dividendët e tyre të spektrit radio në përputhje me parimet e neutralitetit teknologjik dhe të shërbimeve.</p> <p>4. Deri më datë 1 janar 2013 Vendet Anëtare duhet të plotësojnë procedurat e autorizimit për të mundësuar përdorimin e brezit 800 MHz për shërbimet e komunikimeve elektronike. Komisioni bën përjashtime specifike deri më 31 dhjetor 2015 për Vendet Anëtare për të cilët rrethanat e jashtëzakonshme kombëtare ose lokale ose problemet e koordinimit ndërkufitar të frekuencave do të bënin të pamundur vënien në dispozicion të brezit, me kërkesë të motivuar të Vendit Anëtar në fjalë.</p> <p>Nëse një Vend Anëtar vazhdon të ketë me një ose më shumë vende, përfshirë vendet candidate ose në rrugën e aderimit, probleme të vërtetuara koordinimi ndërkufitar të frekuencave të tilla që pengojnë vënien në dispozicion të brezit 800 MHz pas datës 31 dhjetor 2015, Komisioni bën përjashtime të jashtëzakonshme në</p>			<p>shumë i rëndësishëm për sigurimin e mbulimit universal, veçanërisht për zonat me sfida ekonomike, të tilla si zonat rurale, malore ose të largëta, të paracaktuara në përputhje me fushat që janë prioritet kombëtar, duke përfshirë rrugët kryesore të transportit tokësor, dhe për përdorim të brendshëm dhe për komunikim të gjerë si pajisje –pajisje (M2M/IoT).</p> <p>7. Në zbatim të këtij vendimi, do të merren të gjitha masat e nevojshme për të garantuar vënien në dispozicion të spektrit radio të mjaftueshëm për të siguruar mbulimin dhe kapacitetet e nevojshme, në mënyrë që të ketë në dispozicion broadband-in me shpejtësinë më të lartë, dhe që aplikacionet wireless dhe shërbimet e reja të mund të kontribuojnë efektivisht në rritjen ekonomike dhe në realizimin e objektivit për një akses në broadband me shpejtësi të lartë dhe shumë të lartë për të gjithë qytetarët sipas Planit Kombëtar të Broadband.</p> <p>8. Për promovimin, përdorimin me efikasë dhe vënien në dispozicion, në përfitim të qytetarëve dhe të konsumatorëve, lidhur me brezat e përcaktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave për shërbime të lëvizshme broadband dhe aktualisht të lira, AKEP do të kryejë studime novative lidhur me dhënien në</p>		
--	--	--	--	---	--	--

	<p>bazë vjetore deri në kapërcimin e këtyre problemeve.</p> <p>Vendet Anëtare të cilave u është dhënë një përjashtim sipas paragrafit të parë ose të dytë të kësaj pike, duhet të sigurojnë që përdorimi i brezit 800 MHz nuk e pengon vënien në dispozicion të këtij brezi për shërbime të komunikimeve elektronike, të ndryshme nga ato të transmetimeve në Vendet Anëtare fqinje.</p> <p>Kjo pikë aplikohet edhe për probleme të koordinimit të spektrit radio në Republikën e Qipros për shkak se qeverisë së Qipros i është ndaluar kontrolli efektiv në një pjesë të territorit të tij.</p> <p>5. Vendet Anëtare, në bashkëpunim me Komisionin, ushtrojnë një monitorim të vazhdueshëm të nevojave për kapacitete për shërbime broadband wireless . në bazë të rezultateve të analizës të përmendur në nenin 9, pika 4, Komisioni vlerëson dhe raporton, brenda datës 1 janar 2015, në Parlamentin Evropian dhe në Këshill, në lidhje me nevojën për masa që kanë për qëllim harmonizimin e mëtejshëm të brezave të frekuencave.</p> <p>Vendet Anëtare mund të garantojnë, kur është e përshtatshme dhe në përputhje me legjislacionin e BE-së, që kosto direkte e migrimit dhe e rishpërndarjes</p>			<p>përdorim të këtyre brezave, përfshirë kombinimet teknike midis tyre si dhe përvoja e takon çmimeve të dhënies në përdorim. Kur është e përshtatshme, AKEP në bashkëpunim me ministrin promovon aksesin në shërbimet broadband që përdorin brezat nën 1 GHz, në zona të largëta dhe me densitet të ulët popullsie duke vendosur kushtet përkatëse të përdorimit.</p> <p>9. Për brezin e frekuencave të Digjital Dividend 2, do synohet lirimi i tij nga përdorimet aktuale dhe kalimi për broadband sipas afatit maksimal të vendosur nga BE, përmes një procesi të matur, duke gjetur rrugët më të mira teknike e rregullatore në procesin e migrimit të frekuencave dhe duke bërë kujdesin maksimal për ruajtjen e pluralizimit në media si dhe për të garantuar që lirimi i brezit 700 MHz nuk ndikon negativisht tek përdoruesit në marrjen e shërbimeve të programeve dhe ngjarjeve të veçanta audiovizive.</p> <p>10.Ministria, AMA dhe AKEP, në bashkëpunim do të hartojnë një plan masash me të gjitha hapat e nevojshëm, përfshirë proceset e konsultimit me grupet e interesit për realizimin e liritit digjital dividend 2 sipas afatit maksimal të BE-së.</p> <p>11.Administratorët e spektrit në bashkëpunim me ministrinë, do të</p>		
--	--	--	--	--	--	--



	<p>së përdorimit të spektrit radio të kompesohet në mënyrë të përshtatshme në përputhje me legjislacionin kombëtar.</p> <p>6. Kur është e përshtatshme, Vendet Anëtare promovojnë, në bashkëpunim me Komisionin, aksesin në shërbimet broadband që përdorin brezin 800 MHz në zona të largëta dhe me densitet të ulët popullsie. Në këtë mënyrë, Vendet Anëtare vlerësojnë mënyrat dhe, ku është e përshtatshme, zbatojnë masa teknike dhe rregullatore për të garantuar që lirimi i brezit 800 MHz nuk ndikon negativisht tek përdoruesit e shërbimeve për realizimin e programeve dhe ngjarjeve të veçanta.</p> <p>7. Komisioni, në bashkëpunim me Vendet Anëtare, vlerëson arsyet dhe mundësitë e zgjatjes së shpërndarjes së spektrit radio të pa licensuar për sistemet e aksesit wireless, duke përfshirë këtu dhe rrjetet lokale të radiofrekuencave.</p> <p>8. Vendet Anëtare autorizojnë transferimin dhe dhënien me qera të drejtave të përdorimit të spektrit radio për brezat e harmonizuar nga 790-862 MHz, 880-915 MHz, 925-960 MHz, 1710 – 1785 MHz, 1805-1880 MHz, 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz, 2,5-2,9 GHz dhe 3,4-</p>			<p>kryejnë një monitorim të vazhdueshëm të nevojave për kapacitete për shërbime radio dhe në bazë të rezultateve të analizës të parashikuar sipas nenit 12, do ndërmerren rast pas rasti nismat e nevojshme ligjore e rregullatore.</p> <p>12. Kur është e përshtatshme, kostot direkte të migrimin dhe/ose të rishpërndarjes së përdorimit të spektrit radio do të kompesohen në mënyrën e duhur sipas legjislacionit kombëtar.</p> <p>13. Në mënyrë që të garantohet që të gjithë qytetarët të kenë akses në shërbimet e avancuara digjitale, përfshirë këtu edhe broadband-in, në veçanti në zonat periferike dhe me dendësi të ulët popullsie, do të konsiderohet disponueshmëria e një pjese të spektrit radio, të mjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve satelitore dhe broadband të cilat mundësojnë lidhjen me internet.</p> <p>14. Në zhvillimet e rrjeteve të lëvizshme do shqyrtohet mundësia e shtrirjes dhe përdorimit të picocelave and “femtocells” duke marrë parasysh potencialin e këtyre stacioneve bazë dhe përdorimin e përbashkët të spektrit të palicensuar për të shërbyer si bazë për rrjetet wireless, që mund të luajnë një rol të rëndësishëm në kapërcimin e hendekut digjital.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

	<p>3,8 GHz.</p> <p>9. Në mënyrë që të garantojë që të gjithë qytetarët të kenë akses në shërbimet e avancuara digjitale, përfshirë këtu edhe broadband-in, në veçanti në zonat periferike dhe me dendësi të ulët popullore, Vendet Anëtare dhe Komisioni mund të vlerësojnë disponueshmërinë e një pjese të spektrit radio, të mjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve satelitore dhe broadband të cilat mundësojnë lidhjen me internet.</p> <p>10. Vendet Anëtare, në bashkëpunim me Komisionin, shqyrtojnë mundësinë e përhapjes së vënies në dispozicion dhe përdorimin e picocells and femtocells. Ato marrin parasysh potencialin e këtyre stacioneve bazë dhe të përdorimit të përbashkët dhe të palicensuar të spektrit për të shërbyer si bazë për rrjetet wireless, që mund të luajnë një rol kyç në tejkalimin e hendekut digjital.</p>					
<p><i>Neni 7</i> Nevojat e spektrit radio për politikën e tjera të komunikimeve wireless</p>	<p><b>Neni 7</b> <b>Nevojat e spektrit për politikën e komunikimeve të tjera pa tel (wireless)</b></p> <p>Për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të mjeteve audiovizive inovative dhe të shërbimeve të tjera për qytetarët e BE-së,</p>		<p>Neni 9 Nevojat e spektrit për politikën e komunikimeve të tjera pa tel</p>	<p><b>Neni 10</b> <b>Nevojat e spektrit për politikën e komunikimeve të tjera pa tel (wireless)</b></p> <p>Për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve inovative të medias audiovizive dhe shërbimeve të tjera për qytetarët, duke</p>	E Plotë	

	duke patur parasysh përfitimet ekonomike dhe sociale të një tregu të vetëm digjital, Vendet Anëtare, në bashkëpunim me Komisionin, kanë për qëllim të garantojnë vënien në dispozicion të spektrit radio të mjaftueshëm për ofrimin e këtyre shërbimeve në rrugë satelitore dhe tokësore, nëse nevoja justifikohet në mënyrë të qartë.			patur parasysh përfitimet ekonomike dhe sociale të ekonomisë digjitale, administratorët e spektrit në bashkëpunim, do të garantojnë vënien në dispozicion të spektrit të mjaftueshëm për ofrimin e këtyre shërbimeve në rrugë satelitore dhe tokësore, nëse nevoja justifikohet në mënyrë të qartë.		
<i>Neni 8</i> <b>Nevojat e spektrit radio për politika të tjera specifike të BE-së</b>	<i>Neni 8</i> <b>Nevojat e spektrit radio për politika të tjera specifike të BE-së</b> 1. Vendet Anëtare dhe Komisioni mbikëqyrin vënien në dispozicion të spektrit radio dhe mbrojtjen e radiofrekuencave, të nevojshme për ruajtjen e atmosferës dhe të sipërfaqes së tokës, për të lejuar zhvillimin dhe shfrytëzimin e aplikacioneve hapësinore dhe përmirësimin e sistemeve të transportit, në veçanti për sistemin botëror satelitor të lundrimit civil të ngritur nga programi Galileo, për programin evropian të monitorimit të tokës (GMES) dhe për sistemet inteligjente të mbrojtjes dhe të administrimit të transportit. 2. Komisioni, në bashkëpunim me Vendet Anëtare, kryen studime mbi kursimin e energjisë së përdorur për spektrin radio, në mënyrë që të		Neni 11 Nevojat e spektrit për politika të tjera specifike	<b>Neni 11</b> <b>Nevojat e spektrit për politika të tjera specifike</b> 1. Në hartimin e planit kombëtar të frekuencave dhe në proceset e caktimit të spektrit të frekuencave do sigurohet disponueshmëria e spektrit të nevojshëm për sistemet e monitorimit e të ruajtjes së atmosferës dhe të sipërfaqes së tokës, duke lejuar zhvillimin dhe shfrytëzimin e aplikacioneve hapësinore dhe përmirësimin e sistemeve të transportit, në veçanti për sistemin botëror satelitor të lundrimit civil të ngritur nga programi Galileo, për programin evropian të monitorimit të tokës (GMES), për sistemet inteligjente të mbrojtjes dhe të administrimit të transportit (ITS) dhe sistemet Europiane të aviacionit, sipas praktikave të harmonizuara e të miratuara në nivel evropian. 2. Në zbatim të një politike të ekonomisë së gjelbër për të pasur një emetim të ulët të karbonit, do të kryhen studime mbi kursimin e energjisë së përdorur për pajisjet radio, duke marrë në konsideratë mundësinë për të vënë në dispozicion spektrin radio për teknologjitë wireless, të cilat trisin kursimin	E plotë	

	<p>kontribojë në zbatimin e një politike me emetim të ulët të karbonit, duke kursyer energjinë në përdorimin e spektrit radio, dhe merr në konsideratë mundësinë për të vënë në dispozicion spektrin radio për teknologjitë wireless, të cilat rrisin kursimin e energjisë dhe efikasitetin e rrjeteve të tjera të shpërndarjes, të tilla si furnizimi me ujë, duke përfshirë rrjetet inteligjente të shpërndarjes së energjisë dhe sistemet inteligjente të matjes.</p> <p>3. Komisioni, në bashkëpunim me Vendet Anëtare, mundohet të garantojë vënien në dispozicion të spektrit radio të mjaftueshëm, në kushte të harmonizuara, për të mbështetur zhvillimin e shërbimeve të lidhura me sigurinë dhe të qarkullimit të lirë të pajisjeve të lidhura me to, si dhe me zhvillimin e zgjidhjeve inovative ndërvepruese në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes publike, mbrojtjes civile dhe të ndihmës emergjente.</p> <p>4. Vendet Anëtare dhe Komisioni bashkëpunojnë me komunitetin shkencor dhe akademik për të identifikuar një numër të caktuar projektesh kërkimi dhe zhvillimi dhe aplikacionesh inovative, që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm socio-</p>			<p>e energjisë dhe efikasitetin e rrjeteve të tjera të shpërndarjes, të tilla si furnizimi me ujë, duke përfshirë rrjetet inteligjente të shpërndarjes së energjisë (smart energy grids) dhe sistemet inteligjente të matjes (smart metering system).</p> <p>3. Në hartimin e planit kombëtar të frekuencave dhe në proceset e caktimit të frekuencave, përfshirë brezin 700 MHz, do të garantohet vënia në dispozicion e një sasive të mjaftueshme të spektrit radio për të mbështetur zhvillimin e shërbimeve të lidhura me sigurinë publike dhe qarkullimin e lirë të pajisjeve të lidhura me to (PPDR), si dhe me zhvillimin e zgjidhjeve inovatore të ndërvepruese për sigurinë dhe mbrojtjen publike, mbrojtjes civile dhe në rastet e ndihmës emergjente sipas rekomandimeve përkatëse evropiane.</p> <p>4. Administratorët e spektrit të frekuencave dhe ministria do bashkëpunojnë me institucionet e kërkimit shkencor dhe akademik për të identifikuar projektet e kërkimit dhe zhvillimit dhe aplikacionet inovative, që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm socio-ekonomik dhe/ose një potencial për investime dhe marrin parasysh kërkesat e këtyre aplikacioneve për spektër radio dhe, nëse është e nevojshme, marrin në shqyrtim caktimin e një spektri radio të mjaftueshëm për këto aplikacione me kushte teknike të harmonizuara dhe pagesa apo kosto administrative sa më të vogël të mundshme.</p> <p>5. Në hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave dhe në proceset e caktimit të spektrit të frekuencave do sigurohen brezat e nevojshme të frekuencave për realizimin e programeve dhe ngjarjeve të veçanta, në</p>		
--	--	--	--	--	--	--

	<p>ekonomikdhe/ose një potencial për investime dhe marrin parasysh kërkesat e këtyre aplikacioneve për spektër radio dhe, nëse është e nevojshme, marrin në shqyrtim caktimin e një spektri radio të mjaftueshëm për këto aplikacione me kushte teknike të harmonizuara dhe me barrë administrative sa më të vogël të mundshme.</p> <p>5. Vendet Anëtare, në bashkëpunim me Komisionin, mundohen të sigurojnë brezat e frekuencave të nevojshme për realizimin e programeve dhe eventeve speciale, në përputhje me objektivat e BE-së për të përmirësuar integrimin në tregun e brendshëm dhe aksesin në kulturë.</p> <p>6. Vendet Anëtare dhe Komisioni kërkojnë të sigurojnë vënien në dispozicion të spektrit për identifikimin me radiofrekuencë (RFID) dhe të teknologjive të komunikimeve wireless të “Internet of Things” (IoT) dhe bashkëpunojnë për të favorizuar përpunimin e rregullave dhe harmonizimin e caktimit të spektrit radio për komunikimet IoT në Vendet Anëtare.</p>			<p>përputhje me objektivat e përcaktuara në ligjin për median audiovizive.</p> <p>6. Në hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave do sigurohet vënia në dispozicion të spektrit për shërbimet e identifikimit me radiofrekuencë (RFID), të teknologjive të komunikimeve wireless të “Internetit të gjërave” (IoT), të teknologjive me brez të gjerë. Për këtë qëllim do punohet për hartimin e miratimin e rregullave të harmonizuara të caktimit të spektrit radio për komunikimet wireless, në përputhje me praktikën evropiane.</p>		
<p><i>Neni 9</i> <b>Inventari</b></p>	<p><i>Neni 9</i> <b>Inventari</b></p>		<p>Neni 12 Planifikimi</p>	<p><b>Neni 12</b> <b>Planifikimi afatgjatë dhe</b></p>	<p>I plotë</p>	

	<p>1. Do të hartohet një inventar me spektrin radio të përdorur për qëllime komerciale dhe publike.</p> <p>Qëllimet e këtij inventari do të jenë:</p> <p>a) Identifikimi i brezave të frekuencave për të cilët mund të përmirësohet efikasiteti i përdorimit aktual i spektrit radio;</p> <p>b) Ndhimesë në identifikimin e brezave të frekuencave që mund të jenë të përshtatshme për tu ricaktuar dhe mundësitë për përdorim të përbashkët të spektrit radio, me qëllim mbështetjen e politikave të BE-së të përcaktuara në këtë Vendim, duke mbajtur parasysh, në të njëjtën kohë, nevojat e ardhshme të spektrit radio duke u bazuar, ndër të tjera, në kërkesën e konsumatorëve dhe të operatorëve dhe në mundësinë për t'i përmbushur këto nevoja;</p> <p>c) Ndhimë për të analizuar llojet e ndryshme të përdorimit të spektrit radio nga ana e përdoruesve të sektorit publik dhe privat;</p> <p>d) Ndhimë për të identifikuar brezat e frekuencave që mund të caktohen ose të ricaktohen për të garantuar një përdorim më efikas, për të promovuar</p>		afatgjatë dhe inventarizimi	<p style="text-align: center;"><b>Inventarizimi</b></p> <p>1. Në zbatim të këtij dokumenti, me qëllim planifikimin afatgjatë të përdorimit të spektrit të frekuencave AKEP, në bashkëpunim me AMA do të krijojnë një inventar të unifikuar, të përbashkët për spektrin radio të përdorur për qëllime komerciale dhe publike.</p> <p>2. Krijimi i inventarit do të shërbejë:</p> <p>e) Për identifikimin e brezave të frekuencave ku mund të përmirësohet efikasiteti i përdorimit aktual i spektrit radio;</p> <p>f) Të ndihmojë në identifikimin e brezave të frekuencave që mund të jenë të përshtatshme për t'u ricaktuar dhe mundësitë për përdorim të përbashkët të spektrit radio, me qëllim mbështetjen e politikave të përcaktuara në këtë Vendim, duke mbajtur parasysh, në të njëjtën kohë, nevojat në të ardhmen për spektrin radio duke u bazuar, ndër të tjera, në kërkesën e konsumatorëve dhe të operatorëve dhe në mundësinë për t'i përmbushur këto nevoja;</p> <p>g) Të ndihmojë për të analizuar llojet e ndryshme të përdorimit të spektrit radio nga ana e përdoruesve të sektorit publik dhe privat;</p> <p>h) Të ndihmojë për të identifikuar</p>		
--	---	--	-----------------------------	--	--	--

	<p>inovacionin dhe për të përforcuar konkurrencën në tregun e brendshëm, për të studiuar mënyra të reja për ndarjen e spektrit radio, në interes të përdoruesve të sektorit publik dhe të sektorit privat, duke marrë parasysh efektet e mundshme pozitive dhe negative tek përdoruesit ekzistues, të caktimin ose ricaktimit të këtyre brezave ose të brezave fqinjë.</p> <p>2. Në mënyrë që të garantohet një ekzekutim uniform i pikës 1 të këtij neni, Komisioni, duke mbajtur në konsideratë pikëpamjet e grupit “Politikat e spektrit radio”, miraton aktet zbatuese deri më 1 korrik 2013, në mënyrë që:</p> <p>a) Të zhvillojë procedurat praktike dhe formatet e unifikuara për mbledhjen dhe furnizimin me të dhëna, në Komision nga ana e Vendeve Anëtare, mbi përdorimin aktual të spektrit radio, me kusht që të respektohen rregullat në fushën e konfidencialitetit tregtar, sipas nenit 8 të Vendimit nr. 676/2002/KE dhe e drejta e Vendeve Anëtare për të refuzuar dhënien e informacioneve të rezervuara, duke marrë parasysh objektivin për të reduktuar sa më shumë që të jetë e mundur barrën</p>			<p>brezat e frekuencave që mund të caktohen ose të ricaktohen për të garantuar një përdorim më efikas, për të promovuar inovacionin dhe për të përforcuar konkurrencën në tregun e brendshëm, për të studiuar mënyra të reja për ndarjen e spektrit radio, në interes të përdoruesve të sektorit publik dhe të sektorit privat, duke marrë parasysh efektet e mundshme pozitive dhe negative tek përdoruesit ekzistues, të caktimit ose ricaktimit të këtyre brezave ose të brezave fqinjë.</p> <p>3. Në mënyrë që të garantohet një zbatim uniform i pikës 1 të këtij neni, ministri do miratojë një udhëzim mbi procedurat praktike për krijimin dhe administrimin e inventarit si dhe formatet për mbledhjen dhe furnizimin me të dhëna të inventarit sipas praktikës të miratuar nga Bashkimi Evropian mbi përdorimin aktual të spektrit radio, dhe duke pasur parasysh respektimin e akteve ligjore në fuqi për konfidencialitetin e të dhënave.</p> <p>4. AKEP, AMA në bashkëpunim me ministrinë do të përpunojë një metodologji dhe do kryejnë një analizë për tendencat teknologjike, të nevojave të ardhshme dhe të kërkesës për spektër radio në sektorët perkates dhe në veçanti për shërbime që mund</p>		
--	---	--	--	--	--	--

	<p>administrative dhe detyrimet ekzistuese të vendosura ndaj Vendeve Anëtare nga legjislacioni i BE-së, në veçanti detyrimin për të dhënë informacione specifike;</p> <p>b) Të përpunojë një metodologji për analizën e tendencave teknologjike, të nevojave të ardhshme dhe të kërkesës për spektër radio në sektorët e politikës së BE-së të parashikuar nga ky Vendim, në veçanti për shërbime që mund të veprojnë në intervalin e frekuencave të përfshira nga 400 MHz në 6 GHz, me qëllim identifikimin e përdorimeve të rëndësishme, të mundshme ose në fazë zhvillimi, të spektrit radio.</p> <p>Këto akte zbatuese do të miratohen sipas procedurës së ekzaminimit të paraqitur në nenin 13, pika 2.</p> <p>3. Komisioni ka për detyrë administrimin e inventarit të përmendur në pikën 1, sipas akteve zbatuese të përmendura në pikën 2.</p> <p>4. Komisioni kryen analizën e tendencave teknologjike, të nevojave të ardhshme dhe të kërkesës për spektër radio sipas akteve zbatuese të përmendura në pikën 2, shkronja b). Komisioni i paraqet Parlamentit Evropian dhe</p>			<p>të veprojnë në intervalin e frekuencave të përfshira nga 400 MHz në 6 GHz, me qëllim identifikimin e përdorimeve të rëndësishme, të mundshme ose në fazë zhvillimi, të spektrit radio.</p> <p>5. Kopje e inventarit/apo aksesit në formatin elektronik të tij, si dhe rezultatet e analizës për çështjet e përmendura në pikën 2 i paraqiten ministrit.</p> <p>6. Me qëllim administrimin e duhur të spektrit të frekuencave dhe krijimit të inventarit sipas këtij neni AKEP ndërmerr masat e nevojshme për automatizimin dhe menaxhimin e spektrit të frekuencave, sipas metodave dhe teknologjive bashkohore.</p>		
--	--	--	--	---	--	--



	Këshillit një raport mbi rezultatet e kësaj analize.					
<i>Neni 10</i> <b>Negociatat ndërkombëtare</b>	<p><i>Neni 10</i> <b>Negociatat ndërkombëtare</b></p> <p>1. Në negociatat ndërkombëtare që kanë lidhje me spektrin radio aplikohen këto parime:</p> <p>a) Nëse objekti i negociatave ndërkombëtare hyn në kompetencat e BE-së, pozicioni i BE-së do të përcaktohet në përputhje me legjislacionin e BE-së;</p> <p>b) Nëse objekti i negociatave ndërkombëtare hyn pjesërisht në kompetencat e BE-së dhe pjesërisht në ato të Vendeve Anëtare, BE-ja dhe Vendet Anëtare kërkojnë të marrin një pozicion të përbashkët në përputhje me atë çfarë parashikohet në parimin e bashkëpunimit të sinqertë.</p>		Neni 13 Bashkëpunimi ndërkombëtar	<p>Neni 13 Bashkëpunimi ndërkombëtar</p> <p>1. Spektri i frekuencave është burim natyror i fundmë. Administrimi i spektrit duhet të sigurojë përdorimin e frytshëm dhe efektiv të tij, në përputhje edhe me vendimet përkatëse të organizmave ndërkombëtarë dhe detyrimet, që rrjedhin nga konventat ose nga marrëveshjet, ku Republika e Shqipërisë është palë. Shqipëria është anetare e ITU-se nga viti 1922 dhe ka detyrimin për përmbushjen e angazhimeve nga aktet kushtetuese të këtij organizmi.</p> <p>2. Rregullimi i spektrit të frekuencave në planin ndërkombëtar bëhet përmes Radio Rregulloreve të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU). Shqipëria bën pjesë në rajonin 1, sipas ndarjes globale së ITU.</p> <p>3. Për rregullimin e administrimit e harmonizuar në planin global dhe rajonal të spektrit të frekuencave hartohet Plani Kombëtar i Frekuencave. Plani Kombëtar i Frekuencave hartohet në përputhje me radio-rregulloret përkatëse të ITU-së dhe Tabelën për Përcaktimin e Përbashkët Evropian të Frekuencave (ECA).</p>	I Pjesshëm	Përshtatur me kuadrin ligjor kombëtar

	<p>Për qëllimet e zbatimit të paragrafit të parë, shkronja b), BE-ja dhe Vendet Anëtare bashkëpunojnë në përputhje me parimin e unitetit në përfaqësimin ndërkombëtar të BE-së dhe të Vendeve Anëtare të tij.</p> <p>2. BE-ja ndihmon Vendet Anëtare që bëjnë kërkesë, duke u dhënë atyre mbështetje ligjore, politike dhe teknike për të zgjidhur problemet që kanë të bëjnë me koordinimin e spektrit radio me vendet fqinje me BE-në, përfshirë këtu vendet candidate dhe ato në rrugën e aderimit, në mënyrë të tillë që Vendet Anëtare në fjalë të mund të respektojnë detyrimet e tyre sipas legjislacionit të BE-së. Në dhënien e kësaj ndihme, BE-ja përdor të gjithë fuqinë e saj juridike dhe politike për të promovuar zbatimin e politikave të BE-së.</p> <p>BE-ja mbështet gjithashtu, përpjekjet e vendeve të treta për të zbatuar një administrim të spektrit radio që është në përputhje me atë të BE-së, në mënyrë që të mbrohen objektivat e politikës së BE-së në fushën e spektrit radio.</p> <p>Kur Vendet Anëtare kryejnë negociata dypalëshe ose shumëpalëshe me vende të</p>			<p>4. Plani Kombëtar i Frekuencave përcakton brezat e frekuencave për shërbimet e radio-komunikimeve. Për sigurimin e përdorimit të frytshëm dhe pa interferenca të dëmshme të frekuencave, ky plan përmban edhe dispozita, që udhëzojnë përdorimin e frekuencave, si dhe përcaktime të tjera më të hollësishme.</p> <p>5. Me qëllim koordinimi ndërkufitar të përdorimit të frekuencave është e nevojshme miratimi i marrëveshjeve me vendet fqinje për të garantuar përdorimin pa interferenca të frekuencave në veçanti në breza të caktuar.</p> <p>6. Me qëllim përmbushjen e objektivave strategjike të këtij dokumenti është e nevojshme të realizohen brenda vitit 2020 marrëveshjet e koordinimit ndërkufitar për brezat e digital dividendit 2, në kushtet e liritit të tij nga përdorimi televiziv për pjesën më të madhe të vendeve evropiane me qëllim shmangien e interferencave ndërkufitare.</p> <p>7. Nga AKEP, do kryhet përditësimi i marrëveshjeve ndërkufitare për brezat e frekuencave që administron AKEP, në mënyrë që ato të përfshijnë të gjithë brezat kryesore të shërbimeve të lëvizshme e fikse sipas përcaktimeve në praktikën ndërkombëtare. Për këtë qëllim do kërkohet asistencë dhe mbështetje nga ITU.</p> <p>8. Administratorët e spektrit të</p>		
--	--	--	--	---	--	--

	<p>treta, ato duhet të zbatojnë detyrimet e legjislacionit të BE-së. Kur firmosin ose pranojnë në një mënyrë tjetër detyrime të mundshme ndërkombëtare, në sektorin e spektrit radio, Vendet Anëtare, shoqërojnë firmosjen ose çdo akt tjetër pranimit me një deklaratë të përbashkët, në të cilën saktësojnë se do të zbatojnë marrëveshjet ose angazhimet ndërkombëtare në përputhje me detyrimet e tyre sipas Traktatit për BE-në dhe Traktatit për Funkcionimin e BE-së.</p>			<p>frekuencave, AKEP dhe AMA duhet të informojnë periodikisht ministrin për proceset e koordinimit ndërkufitar të frekuencave si dhe çështje që i takojnë politikave të zhvillimit të rrjeteve të komunikimit dhe interferencave.</p> <p>9. Në negociatat ndërkombëtare që kanë lidhje me spektrin radio respektohen detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare dhe angazhimet e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare.</p>		
<p><i>Neni 11</i> <b>Bashkëpunimi ndërmjet organeve të ndryshme</b></p>	<p><i>Neni 11</i> <b>Bashkëpunimi ndërmjet organeve të ndryshme</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Komisioni dhe Vendet Anëtare bashkëpunojnë për të konsoliduar strukturën aktuale institucionale, në mënyrë që të promovohet koordinimi i administrimit të spektrit radio në nivel BE-je, edhe për çështje që prekin drejtpërdrejtë dy ose më shumë Vende Anëtare, me qëllim zhvillimin e tregut të brendshëm dhe sigurimin e realizimit të plotë të objektivave të politikës së BE-së në fushën e spektrit radio.</li> <li>2. Komisioni dhe Vendet Anëtare nxisin organet e standardizimit, CEPT-in, qendrën e përbashkët të</li> </ol>		<p>Neni 14 Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve</p>	<p><b>Neni 14</b> <b>Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për zbatimin e këtij vendimi do të bashkëpunohet në veçanti midis Ministrisë, AKEP dhe AMA. Në hartimin e planit kombëtar të frekuencave dhe rishikimin periodik të tij Ministri bashkëpunon me të gjitha institucionet e përcaktuara në ligjin për komunikimet elektronike si ministria e mbrojtjes, ministria e brendshme dhe shërbimi informativ kombëtar.</li> <li>2. Drejtoria përgjegjëse për politikën e telekomunikacionit në ministri ndjek në vijimësi zhvillimet e politikës spektrale në nivel global dhe rajonal si dhe në BE duke informuar rregullisht ministrin për çështje të rëndësishme të politikës spektrale që kanë impakt në zhvillimet kombëtare.</li> <li>3. Për çështje të politikës spektrale krijohet një komitet/grup këshillimor pranë ministrit. Në këtë komitet marrin pjesë përfaqësues të institucioneve administruese të spektrit, si</li> </ol>	I pjesshëm	Përshtatur në kontekstin kombëtar

	<p>kërkimit të Komisionit dhe të gjitha pjesët përbërëse, të bashkëpunojnë ngushtë mbi çështjet teknike, për të promovuar një përdorim efikas të spektrit radio. Për këtë qëllim, këto institucione sigurojnë mbajtjen e një lidhjeje koherente midis administrimit të spektrit radio dhe standardizimit, në mënyrë që të përforcohet tregu i brendshëm.</p>			<p>dhe ftohen specialiste, ekspertë të planifikimit e administrimit të spektrit. Grupi mbledhet minimalisht një herë në vit me kërkesë të ministrit ose të institucioneve të administrimit të spektrit për çështje specifike.</p>		
<p><i>Neni 12</i> <b>Konsultimi publik</b></p>	<p><i>Neni 12</i> <b>Konsultimi publik</b> Komisioni organizon, kur është e nevojshme, konsultime publike që kanë për qëllim mbledhjen e pikëpamjeve të të gjitha palëve të interesuara dhe të opinionit publik, mbi përdorimin e spektrit radio në BE.</p>		<p>Neni 15 Konsultimi publik</p>	<p>Neni 15 Konsultimi publik Ministri kur është e nevojshme organizon konsultime publike që kanë për qëllim mbledhjen e pikëpamjeve të të gjitha palëve të interesuara dhe të opinionit publik, mbi përdorimin e spektrit radio dhe hartimin apo rishikimin e politikës spektrale.  Autoritetet e administrimit të spektrit, AKEP, AMA kryejnë konsultime periodike me grupet e interesit për çështje të administrimit dhe caktimit të brezave të frekuencave, të lira dhe atyre që parashikohen për përdorim/liruar si dhe për çështjet rregullatore, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi.</p>	<p>I pjesshëm</p>	<p>Përshtatur sipas kontekstit kombëtar</p>
<p><i>Neni 13</i> <b>Procedura e Komitetit</b></p>	<p><i>Neni 13</i> <b>Procedura e Komitetit</b> 1. Komisioni asistohet nga Komiteti për Spektrin Radio, i cili është</p>				<p>na</p>	

	<p>ngritur me Vendimin nr. 676/2002/KE. Ky është një Komitet sipas përcaktimeve të Rregullores (BE) nr. 182/2011.</p> <p>2. Në rastet kur i referohen kësaj pike, zbatohet neni 5 i Rregullores (BE) nr. 182/2011. Në rastin kur Komiteti nuk jep asnjë mendim, Komisioni nuk miraton projekt-aktin zbatues dhe në këtë rast zbatohet neni 5, pika 4, paragrafi i tretë, i Rregullores (BE) nr. 182/2011.</p>					
<p><i>Neni 14</i> <b>Respektimi i orientimeve dhe objektivave strategjikë</b></p>	<p><i>Neni 14</i> <b>Respektimi i orientimeve dhe objektivave strategjikë</b> Vendet Anëtare do të zbatojnë orientimet dhe objektivat strategjikë të përmendura në këtë Vendim brenda datës 1 korrik 2015, përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë Vendim.</p>				na	
<p><i>Neni 15</i> <b>Raportimi dhe rishikimi</b></p>	<p><i>Neni 15</i> <b>Raportimi dhe rishikimi</b> Brenda datës 10 prill 2014, Komisioni i raporton Parlamentit Evropian dhe Komisionit mbiaktivitetin e kryer dhe masat e marra në zbatim të këtij Vendimi. Vendet Anëtare i japin Komisionit të gjithë informacionin e nevojshëm për të kryer analizën për zbatimin e këtij Vendimi.</p>		<p>Neni 15 Zbatimi dhe monitori mi Neni 16 Rishikimi</p>	<p><b>Neni 15</b> <b>Zbatimi dhe monitorimi</b> Mbi bazën e Urdhërit të Kryeministrit Nr. 157, datë 22.10.2018 “Për Marrjen e Masave për Zbatimin e Qasjes së Gjërë Sektoriale/ndërsektoriale, si dhe Ngritjen dhe Funksionimin e Mekanizmit Sektorial/Ndërsektorial të Integruar”, janë krijuar Grupet e Menaxhimit të Integruar të Programeve (“GMIP”) dhe Komitetet</p>	I pjesshëm	Përshtatur në kontekstin kombëtar

	Brenda datës 31 dhjetor 2015 Komisioni shqyrton zbatimin e këtij Vendimi.			<p>Drejtuere Strategjike, për të promovuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, agjencive të ndryshme qeveritare si edhe politikave dhe aktivitetet korresponduese. Komitetit Drejtues Strategjik “Ndërlidhja”, që drejtohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka në përbërje grupin tematik për Telekomunikacionin dhe Broadband, që drejtohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesve të AKEP, AMA dhe institucioneve të tjera të përfshira në proces. Nga pikëpamja operationale, “Grupi Tematik për Telekomunikacion dhe Broadband” nën KDS “Ndërlidhja”, do të ndjekë procesin e vazhdueshëm të implementimit dhe arritjes së objektivave të këtij dokumenti.</p> <p>Neni 16 Rishikimi</p> <p>Dokumenti i politikave spektrale do të rishikohet periodikisht në varësi të zhvillimeve teknologjike dhe angazhimeve ndërkombëtare.</p>		
<i>Neni 16</i> <b>Hyrja në fuqi</b>	<i>Neni 16</i> <b>Hyrja në fuqi</b> Ky Vendim hyn në fuqi ditën e njëzetë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të BE-së.				na	
<i>Neni 17</i> <b>Përfituesit</b>	<i>Neni 17</i> <b>Përfituesit</b> Ky Vendim u drejtohet Vendeve Anëtare. Strasbourg, 14 mars 2012.				na	